



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇE

RAPORT

PËR HARTIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAM BUXHETIN AFATMESËM 2019-2021.

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “ Për Veteqeverisjen vendore ”, në ligjin nr. 68/2017 “ Për Financat e vetëqeverisjes vendore ”, në udhëzimin nr 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, Grupi i Menaxhimit Strategjik, kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2019-2021 sipas strukturës së mëposhtme:

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-së 2019-2021

1. Ngritja e grupit të punës

Nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm me ndarjen sipas programeve të Këshillit të Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbështetet në kalendarin e programit buxhetor afatmesëm miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 17 datë 18.12.2017, për të vepruar sipas strukturave përkatëse me qëllim realizimin e çdo detyre sipas afateve të përcaktuara në vendim.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Nën drejtimin e Kryetarit të GMS, grupi i punës ka punuar për planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 mbështetur:

- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Analizën e realizimit të buxhetit në dy vitet paraardhëse si dhe në zbatimin e tij për vitin 2018.
- Ritjen e lejuar të transfetes së pakushtezuarve parashikuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr 6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e tavanëve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”